



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P.nr.834/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtaren Violeta Husaj Rugova me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit D G nga fshati B, Komuna Pejë për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II Nr.1863/2017 të datës 14.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestarë në prezencë të Prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari, të akuzuarit D G, me datë 17.10.2017, mori dhe shpalli si dhe me datë 18.10.2017 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari D G, i biri i K dhe nënës R e gjinisë G, i lindur me datë ..... në fshatin B Komuna Pejë, ku edhe tani banon, ....., ka të kryer shkollën ....., i gjendjes së mesme ekonomike, më nr. personal ....., dhe me nr.tel ..... shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

-Me datë 20.07.2017, rreth orës 10:25 minuta, në fshatin B K-Pejë, në shtëpinë e të pandehurit, me urdhër të gjykatës gjatë bastisjes nga ana e policisë, fillimisht në oden e burrave e varur në mur i është gjetur dhe konfiskuar 1(një) armë gjahu, kalibër 12GA, me nr. serik 8-552216 se bashku me 25 (njëzet e pesë) fishekë, 1(një) leje më afat të skaduar për armën në fjalë me nr. WRC-09-39140 ndërkaq në njërin nga dhomat tjera e cila ishte e mbyllur me dry, nën krevat i është gjetur më mbajtje, pronësi, kontroll se posedim të paautorizuar armë dhe municion dhe atë: 1 (një) pistoletë prodhim kinez, model “TT”, kalibër 7.62,m nr. serik 33005752, së bashku me 1 (një) karikatorë me 8 (tetë) fishekë të kalibrit 7.62x25mm.

-me çka kryer vepër penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374 par . 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42,43,46,73, të KPK-së, nenit 374 par . 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit D G i shqipton:

## **DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që të akuzuarit D G, i cakton dënim me gjobë në lartësi prej 400€ (katërqind euro ) e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet dënim plotësues, konfiskimi i armës: 1 (një) armë gjahu, kalibër 12GA, me nr. serik 8-552216 së bashku me 25 (njëzetë e pesë) fishekë, 1 (një) leje me afat të skaduar për armën në fjalë me nr. WRC-09-39140, 1 (një) pistoletë prodhim kinez, model “TT”, kalibër 7.62, me nr. serik 33005752 së bashku me 1 (një) karikator me 8 (tetë) fishekë të kalibrit 7.62x25mm, të cilat armë, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi kanë për tu asgjësuar.

**OBLIGOHET** i akuzuari në paguarjen e paushallit gjyqësorë në shumë prej 30€, dhe ne emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€ dhe atë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP/II Nr.1863/2017 të datës 14.08.2017, kundër të akuzuarit D G nga fshati B, Komuna Pejë për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/II Nr.1863/2017 të datës 14.08.2017, në seancën e shqyrtimit fillestarë, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se pasi që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë. Gjithashtu deklaroi se ka dëshirë që arma e gjetisë-llovaqka me qenë se për të ka pasur leje.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se, pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni pasi ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i policit Ali Shala #3064 i datës 20.07.2017, lista e armëve dhe municionit të konfiskuar e datës 20.07.2017, dëftesa mbi konfiskimin e pronës e datës 20.07.2017, deklarata e të pandehurit D G e dhënë në Prokurori me datë 11.08.2017, përmbajtja e dosjes së forenzikës dhe fotografitë e armës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se, i akuzuari e ka pranuar fajësinë qysh në fillim, pati sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestarë, është penduar për veprën penale të kryer, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin gjykata nuk ka gjetë asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të viktimave të krimit.

Vendimi që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi plotësues, konfiskimi i armëve të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit e të cilat armë do të shkatërrohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit është i bazuar në nenin 62 par.1 dhe 2 pika 2.7 të KPRK-së,

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr. 834/17.**

Bashkëpunëtore profesionale  
Besa Dervishaj

GJYQTARJA  
Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar  
ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita  
e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,  
e nëpërmjet të kësaj gjykate